

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 12/5 Prot.,

Tiranë, më 1.10 2025

URDHËR

Nr. 8/4, datë 1.10 2025

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR 8, DATË 09.01.2025 "PËR MIRATIMIN E PLANIT
VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONIN E
AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2025", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.2.2014, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", nenit 13 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, miratuar me Urdhërin e Brendshëm nr. 129, datë 17.06.2012, si dhe në memon e paraqitur nga Sektori i Burimeve Njerëzore,

URDHËROJ:

1. Në Urdhrin nr.8, datë 9.01.2025 "Për Miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2025", i ndryshuar, plani vjetor i pranimeve ndryshon sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh ZENELAJ



PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2025,

1. “Specialist i IT” në Sektorin e IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, Kategoria IV-1, (vakancë e krijuar për shkak dorëheqje e nëpunësit civil);
2. “Specialist i Prokurimeve” në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, Kategoria IV-1, (vakancë e krijuar për shkak dorëheqje e nëpunësit civil);
3. “Përgjegjës IT”, i Sektorit të IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve”, Kategoria III-1, (vakancë e krijuar për shkak dorëheqje e nëpunësit civil).